




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr. 76/24

Datë: 28.08.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe nenin 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkatës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e datës 28.08.2024, mori këtë:

V E N D I M

LEJOHET: Përqendrimi i ndërmarrjeve / Marrja e kontrollit të përbashkët mbi ndërmarrjet Slavonija Power d.o.o dhe Bilogora Power d.o.o. nga ALFI Renewables upravljanje alternativnih investicijskih skladov d.o.o, dhe IVICOM Holding GmbH (pas shitjes së 70% të aksioneve nga "IVICOM" tek "ALFI Renewables").

Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (një mijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 21.06.2024, me Nr. Prot. 388/24-11/H, ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët mbi ndërmarrjet Slavonija Power d.o.o dhe Bilogora Power d.o.o nga ALFI Renewables upravljanje alternativnih investicijskih skladov d.o.o, (blerësi) dhe/mbi IVICOM Holding GmbH (shitësi), pas shitjes së 70% të aksioneve nga "IVICOM" tek "ALFI Renewables".

Procedurat e ndjekura

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë: 29.07.2024;
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë: 02.08.2024;
3. Palët kanë lidhur Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve, të nënshkruar më 6 Qershor 2024.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumë 20,000,000 Euro;
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumë 1,000,000 Euro;
3. Palët kanë lidhur Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve, të nënshkruar më 6 Qershor 2024.

Palët në Përqendrim:

ALFI Renewables, upravljanje alternativnih investicijskih skladov, d.o.o – me adresë të regjistruar në Rrugën, Verovškova u55A, 1000, Ljubljana, me numër të identifikimit: 8775958000. ALFI Renewables, është ndërmarrje sllovene, e angazhuar në menaxhimin e fondeve, të investimeve alternative, e inkuorporuar në vitin 2020, me aktivitet kryesor të regjistruar afarist - menaxhimin e fondeve.

IVICOM Holding GmbH, me adresë të regjistruar në Wiedner Hauptstrasse 76/2/1, A-1040 Vienë, me numër të identifikimit FN 384723w, është ndërmarrje holding, pjesë e grupit të ndërmarrjeve Ivicom, e cila fokusin e ka kryesisht në konsulencë, ndërtim dhe menaxhim të parqeve me erë. Ivicom u krijua më 2012, si rezultat i krijimit të një ndërmarrje të re nga IviCom Consulting, i cili u themelua në Austri më 1991, aktivitetet e tjera ekonomike të Ivicom, përfshijnë eksplorimin e potencialit të erës dhe zhvillimin e projekteve të energjisë së erës. Ivicom zhvillon biznes në Austri, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi, Mal të Zi, Gjeorgji, Shqipëri dhe Tanzani.

Slavonija Power d.o.o., me adresë të regjistruar në Rrugën, Damira Tomljanovića Gavrana 11, 10000 Zagreb, me numrin e regjistrimit 081544156, është e inkuorporuar në janar të vitit 2022 si mjet për qëllime të veçanta me qëllim të zhvillimit të termocentralit diellor "Trenkovo", me fuqi të lidhur prej 9.99 MW, në komunën e Trenkovës, Republika e Kroacisë. Slavonija Power zotëron aset, leje dhe të drejta të caktuara për zhvillimin dhe ndërtimin e termocentralit diellor "Trenkovo". Slavonija Power ende nuk është aktive në treg, nuk ka kapacitete të instaluar dhe nuk ka gjeneruar qarkullim, por pas përfundimit të ndërtimit të termocentralit diellor "Trenkovo", do të kryejë në Republikën e Kroacisë aktivitetin e shfrytëzimit të termocentralit diellor, pra prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike të marrë nga energjia diellore. Slavonija Power nuk ka filiale të regjistruar në Kosovë.

Bilogora Power, me adresë të regjistruar në Rrugën, Damira Tomljanovića Gavrana 11, 10000 Zagreb, Republika e Kroacisë, e regjistruar në Regjistrin e Gjykatës Komerciale të Zagrebit, me numrin e regjistrimit 081509354 (ende nuk është aktive në treg, nuk ka kapacitete të instaluar dhe nuk ka gjeneruar qarkullim. Kjo ndërmarrje, pas përfundimit të ndërtimit të termocentralit diellor "Velika Pisanica", do të kryejë në Republikën e Kroacisë, aktivitetin e shfrytëzimit të termocentralit diellor, pra prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike e marrë nga energjia diellore.

Tregu i produktit, tregu për prodhimin dhe shitjen me shumicë të energjisë elektrike.

Tregu gjeografik, Elementi gjeografik i tregut, mund të përcaktohet si ndërkombëtar.

Analiza e konkurrencës

Tregu i burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe investimi në këtë industri janë kyçe për prodhimin e qëndrueshëm të energjisë elektrike nga burimet solare. Me investimin e propozuar, parashtruesit e kërkesës do të vazhdojnë zgjerimin dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese në industrinë e energjisë së ripërtëritshme në Republikën e Kroacisë. Kjo do të kontribuojë në rritjen e aktiviteteve të kompanive të synuara, duke u mundësuar atyre të shfrytëzojnë potencialin e ardhshëm të energjisë së ripërtëritshme.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë sepse njëra palë në transaksion, përmes kompanive të ndërlidhura, gjeneron të hyra në Republikën e Kosovës. Megjithatë, transaksioni i propozuar nuk paraqet shqetësime për konkurrencën, pasi asnjëra palë nuk është aktive në tregun përkatës të Kosovës. Të hyrat që realizohen në Kosovë janë të papërfillshme dhe kompanitë e synuara nuk operojnë fare në Kosovë. Prandaj, transaksioni nuk do të çojë në parandalim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës, nuk krijon apo forcon pozitën dominuese dhe nuk ka efekte negative në tregun kosovar. Bazuar në këtë, transaksioni është në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nuk do të ndikojë në konkurrencën në Republikën e Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij, Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

AUTORITETI I KONKURRENCËS KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi-Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva